



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Përgjithshëm



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201501511/5

Tiranë ____/____/2015

Lënda: *Rekomandim për dhënien e kompensimit financiar të energjisë elektrike, si shtesë në masën e pensionit të pleqërisë të shtetasit S. S. V.*

Drejtuar : **Znj. Miranda KOKA**
Drejtoreshe e Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve
Shoqërore

DURRËS

E nderuar znj.KOKA,

Pranë institucionit të Avokatit të Popullit ka paraqitur ankesë shetasi S.S. V, banues në Krujë, në përmbajtjen e së cilës ankohet për mosdhënien e kompensimit të energjisë elektrik që nga muaji Prill 2015.

Sipas shpjegimeve të tij, ankuesi gëzon pensionin e pleqërisë dhe ka përfituar deri në muajin Prill 2015 kompensimin për shkak të rritjes së çmimit të energjisë elektrike në shumën e 660 lekëve në muaj.

Pretendimi i tij qëndron në faktin se që nga muaji Prill 2015 nuk i është dhënë e drejta e përfitimit të këtij kompensimi.

Pas marrjes në shqyrtim të këtij rasti, kemi proceduar me kërkesë për shpjegime pranë institucionit tuaj.

Me shkresën nr.5971/1 datë 06.10.2015, na është kthyer përgjigje se:

"Kushtet e përfitimit në zbatim të VKM-së nr.8 dt. 14.01.2015 "Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike deri në 300 KWH në muaj", janë të përcaktuara në VKM-në 565 dt.09.08.2006, ku në pikën 1 të kësaj VKM-je thuhet se përfitojnë kompensim, për nivelin e konsumit 200 KWH në muaj.

Nga verifikimi i dokumentave të dorëzuar nga shtetasi S.V, rezulton se sipas fotokopjes së librezës së energjisë elektrike nuk ka konsumuar 200 KWH në muaj energji për vitin 2015.

Për sa më sipër i ndëpritet kompensimi i energjisë elektrike”.

Sipas kësaj përgjigjeje, konfirmohet fakti se shtetasi S.V, nuk ka përfituar nga VKM-ja nr.8 dt. 14.01.2015 “Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike deri në 300 KWH në muaj”, megjithëse ky akt normativ në dispozitat e tij ka parashikuar shtesë në masën e pensionit të plotë të pleqërisë për kryefamiljarët.

Në analizë të bazës ligjore në fuqi lidhur me këtë çështje, rezulton se në asnjë rast në dispozitat e VKM-së nr.8 datë 14.01.2015, nuk është përcaktuar se kushtet e përfitimit të këtij vendimi janë të përcaktuara në VKM-në 565 datë 09.08.2006.

Konkretisht VKM-ja Nr. 8, datë 14.1.2015 “Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike deri në 300 KWH në muaj”, pika 1/c ka përcaktuar se përfitojnë:

“1. Kompensimin e diferencës së çmimit të energjisë elektrike, për efekt të heqjes së fashës së konsumit deri në 300 Kwh në muaj, për:

c) kryefamiljarët, që përfitojnë pension pleqërie shtetëror ose pension pleqërie fshati, por që janë me banim në qytet dhe nuk kanë anëtarë të familjes të punësuar ose të vetëpunësuar, ...”

Ndërsa Udhëzimi nr.1 datë 02.02.2015 “Mbi zbatimin e vendimit nr.8 datë 14.01.2015 të Këshillit të Ministrave për mbrojtjen e shtresave në nevojë, nga heqja e fashës së konsumit të energjisë elektrike deri në 300 KWH për faturimin e çmimit të energjisë elektrike”, në pikën 4 ka përcaktuar se:

“4. Kompensimi i diferencës së çmimit të energjisë elektrike për shkak të heqjes së fashës së konsumit deri në 300 KWH, fillon nga data 01.02.2015 dhe i përgjigjet energjisë elektrike të shpenzuar nga data 01.01.2015. Me qëllim që gjenerimi dhe pagesa e kompensimeve në favor të përfituesve të kryhet pa krijuar shqetësime, fillimisht nga ISSH-ja, si dokumenta që përcaktojnë të drejtën e përfitimit janë të vlefshme ato dokumenta, të cilat shërbejnë për dhënien e kompensimit sipas VKM nr.565 datë 09.08.2006 “Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, nga rritja e çmimit të energjisë elektrike.”

Në këtë rast referimi është vetëm për dokumentacionin ekzistues, me qëllim lehtësimin e personave përfitues, por jo kushtet e përfitimit. Fotokopja e librezës së energjisë elektrike, siç është e përcaktuar në aktet nëligjore të sipërcituara, duhet të paraqitet pranë Agjensive Lokale të Sigurimeve Shogërore për të vërtetuar se përfituesi nuk ka detyrime të papaguara.

Nga dokumentacioni i paraqitur, shtetasi S.V nuk ka detyrime të energjisë elektrike të papaguar.

Sa më lart, me qëllim përfitimin e së drejtës për të përfituar kompensimin e energjisë elektrike, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”, si dhe në bazë të nenit 21/b të Ligjit Nr.8454

datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, ku thuhet se : *"Paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive",*

REKOMANDOJMË:

Dhënien e kompensimit financiar të energjisë elektrike, si shtesë në masën e pensionit të pleqërisë të shtetasit S.V .

Në përputhje me nenin 22 të Ligjit "Për Avokatin e Popullit", ku thuhet shprehimisht se: *"Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit",*

Lutemi ta shqyrtoni dhe të na vini në dijeni për qëndrimin tuaj ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin Tuaj,

K O M I S I O N E R I

Ermir KAPEDANI

Konc.M.Morina
dt.23.11.2015